

URDHËR
Nr. 424, datë 24.7.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE PËR SHPËTIMIN NË NDËRTIMET E DESTINUARA PËR BANIM

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, pikën 2 të nenit 22, 41 të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, të ndryshuar, nenin 10 të ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullave teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në strukturat, ndërtimet e destinuara për banim, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri.

2. Autoritetet vendore të planifikimit të territorit miratojnë planet zhvillimore, lejet e zhvillimit, lejet e ndërtimit, vetëm pasi të jetë parashikuar plotësimi i normave dhe kushtet teknike të mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit, në përputhje me rregullat teknike, të miratuara në këtë urdhër.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen personat fizikë, juridikë që hartojnë projekte në përputhje me legjislacionin për planifikimin e territorit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

4. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohen sektorët e PMNZSH-së në institucionin e prefektit të qarkut, ndërsa për kontrollin ngarkohet drejtoria e PMNZSH-së në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

RREGULLA TEKNIKE

PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE PËR SHPËTIMIN NË NDËRTESA TË DESTINUARA PËR BANIM

1. TË PËRGJITHSHME

1.1. QËLLIMI

Rregullat teknike kanë për qëllim të përcaktojnë masat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në ndërtesat e destinuara për banim.

2. OBJEKTIVAT

Për parandalimin e zjarreve, si dhe shpëtimin e njerëzve, të mirave materiale, objektet e klasifikuara në dispozitën 1.1, duhet të plotësojnë kushtet:

2.1 Të minimizojnë shkaqet e zjarreve.

2.2 Të garantojnë qëndrueshmërinë ndaj zjarrit të strukturave ndërtimore dhe të sigurojnë ndihmën ndaj të rrezikuarve.

2.3 Të kufizojnë përhapjen e zjarrit në brendësi të objektit.

2.4 Të mundësojnë largimin e të rrezikuarve nga ambienti ku ka rënë zjarr.

2.5 Të kufizojnë përhapjen e zjarrit në objektet që janë pranë.

2.6 Të garantojnë mundësinë për skuadrat zjarrfikëse dhe të shpëtimit, që të ndërhyjnë e punojnë në kushte të sigurta.

3. FUSHA E ZBATIMIT

Rregullat teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin zbatohen për objekte të përcaktuara në pikën 1.1 kur ato ndërtohen të reja, për objekte të cilat rikonstruktohen në mënyrë thelbësore, si edhe për objekte ekzistuese kur ekzistojnë mundësitë.

4. PËRCAKTIME DHE KLASIFIKIME

4.1 Me "rikonstruksion thelbësor" do të nënkuptohen ato ndryshime në strukturën e objektit, të cilat sjellin ndryshime në më shumë se 50 % të volumit të tij, në kafazin e shkallëve, ose ndryshime në lartësinë e objektit.

4.1 “Korridor i verbër” është pjesë e një korridori ku është e mundshme dalja vetëm në një drejtim.

4.2 “Evakuim horizontal progresiv” është mënyrë evakuimi, që parashikon spostimin e të rrezikuarve në një ambient të sigurt për t’i mbajtur dhe mbrojtur ata, deri sa të mundësohet largimi drejt një vendi tjetër të sigurt.

4.3 “Kalim horizontal i mbrojtur” është lëvizja midis ndarjeve drejt vendeve të sigurta, kur kryhet në një mjedis të mbrojtur nga elementë vështirësisht të djegshëm.

4.4 “Kati i daljes nga ndërtesa” është kati nga ku është i mundur largimi i të rrezikuarve drejtpërdrejt ose nëpërmjet kalimeve horizontale të mbrojtura jashtë ndërtesës.

4.5 “Shkallë të sigurisë së jashtme” janë shkallë me parapet të rregullt e të realizuar me materiale të klasës 0 ose 1 të rezistencës ndaj zjarrit.

5. PËRKUFIZIME

“Materiale të padjegshme” janë materiale që nën ndikimin e zjarrit, ose të temperaturave të larta nuk flakërohen, nuk digjen, nuk karbonizohen.

“Materiale vështirësisht të djegshme” janë materiale që nën ndikimin e zjarrit, ose të temperaturave të larta flakërohen me vështirësi, digjen ose karbonizohen dhe vazhdojnë të digjen vetëm në prani të burimit të zjarrit.

“Materiale të djegshme” janë materiale që nën ndikimin e zjarrit, ose të temperaturave të larta flakërohen, digjen pa flakë dhe vazhdojnë të digjen edhe pas heqjes së zjarrit.

“R” është rezistenca e pjesëve të jashtme të objektit ndaj zjarrit shprehur në minuta (0-120 minuta).

“REI” është rezistenca e pjesëve të brendshme të objektit shprehur në minuta (0-120 minuta).

“RE” është rezistenca e dyerve të banesave, e shprehur në minuta.

Rezistenca e materialeve ndaj zjarrit e përcaktuar sipas klasave për objektet e destinuara për banim.

“Lartësia antizjarr” është lartësia e objekteve e shprehur në metra, me ndarje të tillë: 0-24 metër, 24-54 metër, mbi 54-80 metër, mbi 80 m.

“Klasa 0” janë materiale të padjegshme.

“Klasa 1” janë materiale vështirësisht të djegshme.

“Klasa 2” janë materiale të djegshme.

“Klasa 1 IM” janë materiale - pajisje për mobilim, që kanë si përbërës lëndë të tilla si dru i laminuar plus përbërës pambuku, leshi etj, si dhe nënproduktet e tyre e që përdoren për mobilimet e brendshme.

6. KARAKTERISTIKAT NDËRTIMORE

6.1 KLASIFIKIMI

TABELA A

Tipi i ndërtesës	Lartësia antizjarr e ndërtesës	Sipërfaqja maksimale e ambienteve në (m ²)	Sipërfaqja maksimale (m ²) e katit që i përkon një shkallë në ndërtesë	Tipi i kafazit të shkallëve dhe të paktën një kafaz për ashensor	Karakteristikat “REI” të kafazit të shkallëve dhe ashensorit, të filtrit të tymit, të dyerve, të elementëve e nënndarjeve në kate
a	Mbi 12-deri 24 m	8 000	500	Asnjë përcaktim	60 (**)
			500	Të paktën të mbrojtura n.q.s. nuk përmbushen kërkesat e pikës 7.2.	60
			550	Të paktën të provës së tymit të brendshëm	60
			600	E provës së tymit	60
b	Mbi 24 deri 32 m	6 000	500	Asnjë përcaktim	60 (**)
			500	Të paktën të provës së tymit të brendshëm n.q.s. nuk përmbushen kërkesat e pikës 7.2.	60
			550	Të paktën të provës së tymit të brendshëm	60
			600	Të provës së tymit	60
c	Mbi 32 deri 54 m	5 000	500	Të paktën të provës së tymit të brendshëm	90
d	Mbi 54 deri 80 m	4 000	500	Të paktën të provës së tymit të brendshëm me filtër të ventilimit jo me të vogël se 0.36 m ² .	90

e	Mbi 80 m	2 000	350(*)	Të paktën të provës së tymit të brendshëm me filtër të ventilimit jo me të vogël se 0.36 m².	120
---	----------	-------	--------	--	-----

(*) Me minimumin 2 shkallë për çdo ndarje kati. Në tarracën e ndërtesës duhet të parashikohet vend për uljen dhe ngritjen e helikopterëve të ndihmës së shpejtë, i cili të jetë i arritshëm nga çdo shkallë

(**) Vetëm për elementet e ndërrave ndërmjet dhomave.

6.2 REZISTENCA NDAJ ZJARRIT E STRUKTURAVE

Kërkesat e rezistencës ndaj zjarrit të strukturave ndërtimore, duhet të vlerësohen në bazë të përshkrimeve dhe modaliteteve të provës, të përcaktuara nga dispozita të veçanta, si dhe akte nënligjore, në varësi të tipit të materialit të përdorur, si beton, çelik, dru masiv, dru i laminuar, elementë të përbërë, materiale të vernikuara etj.

Për strukturat me rrezik zjarri specifik, duhet të aplikohen normat përkatëse për atë lloj rreziku, të cilat duhet të përcaktohen me akte nënligjore të veçanta.

6.3 KARAKTERISTIKAT KONSTRUKTIVE

Rezistenca ndaj zjarrit e strukturave dhe e sistemeve të ndërrave sipas lartësisë duhet të garantojë respektivisht kërkesat e R, REI, siç përcaktohet më poshtë:

- kate të ndërmjetme R/REI 60-90;
- ndërtesat në lartësi antizjarr deri në 24 m, R/REI 90;
- ndërtesat në lartësi mbi 24 m R/REI 90-120.

Për strukturat dhe sistemet me ndarje zonash me rrezik specifik, ku përfshihen porta dhe elemente të veçanta ndarëse e mbyllës, duhet të aplikohen norma përkatëse, të parashikuara në aktet nënligjore.

7. ZGJEDHJA E ZONËS

7.1 HYRJA NË ZONË

Për të hyrë në zonën ku ndodhen ndërtesat, duhet të plotësohen këto kushte minimale:

- Gjerësia: 3,50 m;
- Lartësia e lirë: 4,00 m;
- Rrezja e kthimit: 13,00 m;
- Pjerrësia jo mbi 10%;
- Rezistenca ndaj peshës: të paktën 20 ton (8 në aksin e parë dhe 12 në aksin e prapmë; hapi 4,00 m).

7.2 AFRIMI DHE VENDOSJA E AUTO-SHKALLËS

Për çdo ndërtesë të tipit “a” e “b” (6.1, tabela A) duhet të sigurohet mundësia e afrimit dhe vendosjes së autoskallës zjarrfikëse, sipas skemës bashkëngjitur, të paktën nga një dritare ose ballkon çfarëdo, të çdo kati.

Në ato raste kur detyrimi i mësipërm nuk plotësohet, ndërtesat e tipit “a” duhet të pajisen të paktën me shkallë të tipit të mbrojtur, si dhe ndërtesat e tipit “b” të pajisen të paktën me shkallë të provës së tymit të brendshme (shih tabelën A).

- hyrjet e përhershme, të detyrueshme nga norma të veçanta, ndërmjet kafazit të ashensorit dhe dhomës së makinerisë;
- portat e inspektimit dhe portat e ndihmës së shpejtë, me të njëjtat karakteristika të rezistencës nga zjarri si kafazi i lëvizjes;
- hapësirat e ajrimit dhe shkarkimit të produkteve të djegies sipas përcaktimeve të mëposhtme.

Kafazi i ashensorit duhet të ketë sipërfaqe të përhershme të ajrimit jo më të vogël se 3 % të seksionit dhe në çdo rast jo më të vogël se 0,20 m². Ky ajrim mund të arrihet edhe me oxhakë, që përshkojnë ndarjen e makinerisë, me kusht që të jenë të realizuara me elementë të rezistencës ndaj zjarrit të njëjtë me ato të vetë kafazit të ashensorit.

Në kafazin e ashensorit lejohet instalimi i pajisjeve për mbrojtjen nga agjentët atmosferikë.

Në kafazin e ashensorit nuk lejohet të kalojnë tuba tymi, tubacione etj., që nuk i përkasin impiantit të ashensorit.

Kur numri i ashensorëve është më shumë se dy, sipërfaqet e përhershme të ajrimit duhet të vendosen të paktën në dy kafaze të ndara nga njëri tjetri.

Filtri i provës së tymit, për kafazin e shkallëve dhe atë të ashensorit mund të jetë i përbashkët.

12.2. ASHENSORËT ANTIZJARR

Në objektet e tipit (d), e të destinuara për banim, në projektim duhet të parashikohet një ashensor antizjarr, i cili është i dobishëm për rastet e zjarreve në operacione të ndihmës për evakuimin e të rrezikuarve, i cili realizohet si më poshtë:

12.2.1 Hapësirat e strukturave të këtyre objekteve për banim, ku vendosen këto pajisje duhet të kenë rezistencën ndaj zjarrit REI 120; hyrjet për në kate duhet të kenë kaluar provën e filtrave të tymit, me rezistencë ndaj zjarrit REI 120; këto pajisje duhet të jenë vendosur direkt nga jashtë, nëpërmjet filtrit të provës së tymit, kjo e realizuar me materiale strukturore me rezistencë ndaj zjarrit REI 120;

12.2.2 Ashensorët antizjarr ndërtohen në mënyrë të tillë, që të kenë dopio sistem elektrik, ku njëra është për siguri;

12.2.3 Për rastet e zjarreve duhet realizuar kalimi automatik i sistemit elektrik të zakonshëm, në sistemin elektrik të sigurisë;

12.2.3 Në rastet e zjarreve, këta ashensorë i rezervohen personelit të strukturave të shërbimit zjarrfikës dhe të shpëtimit;

12.2.4 Objektet me ashensor antizjarr me sistem elektrik të zakonshëm duhet të sigurohen me:

- hapësirë të veçantë në objekt;
- sistem citofonie në kabinë.

13. NDARJET KU VENDOSEN MAKINERITË

Objekt i këtyre rregullave janë dhe ambientet ku vendosen makineritë. Ato duhet të jenë të ndara nga ambientet e tjera të ndërtesës me strukturë rezistente ndaj zjarrit të njëjtë me atë të kafazit të ashensorit dhe shkallëve.

Hyrja për në ndarjet e makinerive duhet të ketë të njëjtat karakteristika antizjarr me ato të kafazit të ashensorit ose të shkallëve.

Në qoftë se ambienti i vendosjes së makinerive është në tarracë, hyrja në këtë ambient mund të bëhet përmes kafazit të ashensorit ose të shkallëve të pajisur me një derë antizjarr. Ambientet e makinerive duhet të kenë një sipërfaqe të përhershme ajrimi jo më të vogël se 3 % të sipërfaqes së dyshemesë, me një minimum prej 0,05 m², e realizuar kjo me dritare ose oxhakë, me dalje në ajër të hapur, me lartësi të paktën të barabartë me atë daljes së ajrimit të vetë kafazit të lëvizjes së ashensorit.

14. KOMUNIKIMI

Rrugët e komunikimit për zonat me rrezik të veçantë, duhet të plotësojnë kërkesat normative për atë lloj rreziku dhe përcaktohen me akte nënligjore të veçanta.

Komunikimi ndërmjet shkallëve, ashensorëve ambienteve të veçanta të ndërtesës, bëhet sipas përcaktimeve në tabelën B.

TABELA B

Tipi ndërtesës	Mënyra e komunikimit
a	Direkt
b	Përmes kalimeve me ndarje me rezistencë ndaj zjarrit REI 60 dhe rezistencë ndaj zjarrit të dymit RE 60
c	Përmes filtrit të provës së tymit, me rezistencë të ndarjeve ndaj zjarrit REI 60 dhe rezistencë të dymit RE 60
d, e	Hyrje direkte vetëm nëpërmjet hapësirave të jashtme

15. SHKALLËT, KORRIDORI I HYRJES DHE KALIMET

15.1 Qëndrueshmëria ndaj zjarrit e materialeve

Shkallët duhet të jenë të ndërtuara me materiale të padjegshme.

Lejohen materiale suvatimi vështirësisht të djegshme për korridoret e hyrjes, si dhe për kalimet e çfarëdoshme, si dhe në mënyrë të kufizuar në ndërtesat e tipit "a" dhe "b".

Këto materiale mund të lejohen edhe për veshjen e shkallëve.

Nuk janë objekt i këtyre përcaktimeve korridoret dhe shkallët brenda të njëjtës njësi.

16. ZONA ME RREZIK TË VEÇANTË

Masat mbrojtëse kundër zjarrit për zonat me rrezik të veçantë në ndërtesat përkatëse (ambiente për ekspozim dhe shitje, depozita të materialeve të djegshme etj.), përcaktohen me akte nënligjore të veçanta.

16.1 Ndarje të përcaktuara për depozita.

16.2 Depozita të substancave të lëndëve të djegshme.

Lëndët e djegshme duhet të jenë të vendosura në më pak se volumi i depozitimit. Është e këshillueshme të sistemohen në brendësi të ndërtesës nëpër rafte metalikë të përshtatur si rezervuarë me lëndë antizjarr, në kushte të përshtatshme higjeno-sanitare. Rafte të tillë vendosen në ndarjet që shërbejnë si magazinë.

16.3. Ndarje me sipërfaqe jo më të vogël se 12 m², të destinuar për magazinim të materialeve lehtësisht të djegshme:

- Ndarje të tilla mund të jenë të vendosura edhe në sipërfaqe të brendshme (dhomë), në kuotën ± 0.00 deri -10 metër. Strukturat ndarëse duhet të kenë të paktën karakteristika REI sipas tabelës A, si dhe të jenë të pajisura me pajisje vetëkryqëse në raste rreziku. Ngarkesa e flakës në këto ndarje duhet të jetë e kufizuar në 60 kg/m².

- Në këto ndarje duhet të jetë instaluar një impiant automatik diktimi e sinjalizimi për zjarret që në fillësë.

- Ventilimi natyral nuk duhet të jetë më pak se 1/40 e sipërfaqes të objektit.

- Në qoftë se nuk është e mundur të arrihet ajrimi natyral i raportit të mësipërm, realizohen dy ajrime mekanike deri sa të sigurohet një sipërfaqe ajrimi e barabartë me 25 % të asaj të parashikuar.

- Pranë dyerve të këtyre ndarjeve duhet të jetë instaluar një fikëse zjarri.

17. IMPIANTE TË KONDICIONIMIT DHE VENTILIMIT

Impiantet e kondicionimit dhe të ventilimit mund të jenë qendrore ose të lokalizuara. Këto impiante duhet të plotësojnë këto kushte:

17.1 Të evitojnë riciklimin e produkteve të djegshme ose gazrave të tjerë të rrezikshëm, prishjen e ajrit, si dhe të mospërhapjen e tyre në objektet pranë;

17.2 Të parandalojnë përhapjen e tymit, ose të flakës në fazën e fillimit të zjarreve.

18. IMPIANTE QENDRORE

- Grupet frigoriferike nuk mund të jenë të instaluar në një vend me impiante të prodhimit të

nxehtësisë.

- Grupet frigoriferike duhet të jenë të instaluar në shtesa objektesh të ndërtuara në struktura të veçanta, me karakteristika, si dhe me rezistencë ndaj zjarrit jo më të vogël se REI 60, me dalje të drejtpërdrejta nga jashtë ose nëpërmjet rrugëve ku dyert e kanë rezistencën ndaj zjarrit RE 60 dhe të jenë të pajisura me sisteme vetëhapës nga brenda.

Hapësirat në objekte ku janë instaluar grupet frigoriferike, si dhe sipërfaqja e tyre minimale që ato zënë, nuk duhet të jetë më pak se $1/20$ e sipërfaqes të përgjithshme të objektit.

- Grupet frigogjenë duhet të shfrytëzojnë si lëngje rrjedhës, prodhime jo të djegshëm dhe jo helmues.

- Grupet frigoriferik që prodhojnë solucione ujore të amoniakut, mund të jenë të instaluar vetëm jashtë objektit të destinuar për banesë, ose në objekte ngjitur me karakteristika analoge të centraleve termike të ushqyer me burime gazi.

- Centralet frigoriferike të destinuar për mbajtje grupesh termo-frigoriferike me thithje të nxehtësisë direkte, duhet të respektojnë dispozitat në fuqi për parandalimin e zjarreve, për impiantet e prodhimit të nxehtësisë, referuar tipave të lëndëve të djegshme.

- Nuk është i pranueshëm shfrytëzimi i ajrit të ricikluar në ndarje që shërbejnë si kuzhinë, garazhe, si dhe çdo hapësirë me rrezik specifik.

19. KATE NËNTOKËSORË

Sipërfaqja e lirë në shërbim të banorëve lejohet të vendoset vetëm deri në kuotën -10,00 m.

Për sa më sipër, zonat e vendosura në kuotat - 7,50 m dhe -10,00 m, duhet të jenë të mbrojtura nga impiante automatike të fikjes së zjarreve me ujë, të ndara dhe të komanduara nga impiante diktimi dhe sinjalizimi antizjarr.

Ndarjet që nuk shërbejnë për banim, destinacioni i të cilave përputhet me aktivitete në ndihmë të banorëve, masat e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në këto ndarje përcaktohen me akte nënligjore të veçanta.

20. VENDPARKIMET

Ambienti që ndodhet në brendësi të objektit në kuotat -7,50 m dhe -10,00 m, që shërben për vendqëndrim automjetesh, të pajisen me sistem diktim - sinjalizimi kundër zjarrit. Këto sisteme antizjarr të jenë të programuara që të sinjalizojnë zjarrin që në fillësë.

Në vendparkimet me kapacitet mbi 20 automjete dhe që ndodhen në kuotat e mësipërme, instalohen sisteme stacionare automatike të fikjes së zjarrit me ujë.

Kur ambienti është i ndarë me ndarje të veçanta me mure të paktën “REI” 60 mund të mos vendoset sistemi automatik statik.

Në vendparkimet duhet të vendoset impianti i filtrimit të gazrave dhe tymrave.

21. IMPIANTET E PRODHIMIT TË NXEHTËSISË PËR NGROHJE

Implantet e prodhimit të nxehtësisë përveç se duhet të plotësojnë normat përkatëse në fuqi, duhet të plotësojnë edhe ato të përcaktuara në tabelën C.

Tabela C

TIPI I LËNDËS SË DJEGSHME			
Tipi ndërtësës	i lëngshëm ose ngurtë	Gaz me densitet në raport me ajrin < 0.8	Gaz me densitet në raport me ajrin > 0.8
a	❖	❖	◆
b	❖	❖	○
c	❖	❖	○
d	○	■	○
e	○	■	○

Legjenda:

❖= Lejohet brenda volumit të ndërtesës

■= Ndalohet brenda volumit të ndërtesës por lejohet në tarracën më të lartë të saj.

●= Ndalohet brenda volumit të ndërtesës.

◆= Ndalohet në katet nëntokë.

Në objektet, që klasifikohen në dispozitën 1.1, lejohen të punojnë impiante me çdo lloj lënde të djegshme, me të vetmin kusht, që ato të punojnë me gaz me përqendrim përkundrejt ajrit > 0.8 .

Këto impiante duhet të vendosen jashtë ndërtesës.

22. IMPIANTET ELEKTRIKË

Për parandalimin e minimizimin e zjarreve, impiantet elektrike duhet të plotësojnë këto kushte:

22.1 Nuk duhet të krijojnë premisë për zjarr dhe shpërthim;

22.2 Nuk duhet të krijojnë burime ose rrugë ushqimi, që favorizojnë shpërndarjen e zjarrit;

22.3 Të jenë të vendosur në mënyrë të tillë, që një prishje e mundshme e impiantit të mos nxjerrë të gjithë sistemin jashtë shërbimit;

22.4 Të jenë të pajisur me aparatura në pozicion “gatishmërie”, ku treguesit e qarqeve të jenë të shënuara qartë;

22.5 Ushqimi i siguresave duhet të jetë me shkëputje automatike të shkurtër, më të vogël ose e barabartë me 0,5 sekonda për impiantet e shpërndarjes, alarmit, ndriçimit dhe më e vogël ose e barabartë me 15 sekonda për pajisjet antizjarr dhe impiantet hidrike antizjarr;

22.6 Mekanizmi i ngarkimit të baterive (akumulatorëve për ashensorët) duhet të jetë i atij tipi automatik, që e shpërndan ngarkimin brenda 12 orësh;

22.7 Pavarësia e ushqimit të siguresave duhet të përmbushë kërkesat e ndihmës së shpejtë dhe të fikjes në kohën e nevojshme.

22.8 Për çdo rast pavarësia minimale duhet të vijë e stabilizuar për çdo impiant si më poshtë:

- lajmërim, zbulim, diktim, alarm: 30 minuta;

- ndriçim i sigurt: 1 orë;

- pajisjet antizjarr: 1 orë;

- impiantet hidrik antizjarr: 1 orë.

22.9 Instalimet e grupeve elektrogjene duhet të jenë konform normave teknike të përcaktuara në fuqi.

22.10 Impiantet e ndriçimit duhet të sigurojnë një nivel ndriçimi jo më të vogël se 5 luks në një metër lartësi, në katin e shkelur në rrugët e daljes;

22.11 Vendosen llapma teke emergjence me ushqim të pavarur, por që sigurojnë ndriçim të paktën për një orë;

22.12 Kuadri elektrik i përgjithshëm duhet të jetë vendosur në pozicion të dukshëm, lehtësisht të përdorshëm, të ketë tregues me sinjal dhe i mbrojtur nga zjarri.

22.13 Në ndërtesat e tipit “c”, “d”, “e”, duhet të instalohen sistemi i ndriçimit të emergjencës, i cili duhet të garantojë ndriçim të mjaftueshëm dhe sinjalizim për rrugët e evakuimit.

Ky sistem duhet të ketë ushqim të pavarur, qendror ose lokal, i cili duhet të sigurojë zgjatjen dhe nivelin e ndriçimit, për një evakuim normal të ndërtesës në kohë.

23. PËRDORIMI I GAZIT TË DJEGSHËM

Furnizuesit kryesorë të gazit të djegshëm në objektet e përcaktuara në dispozitën 1.1, duhet të jenë jashtë mureve dhe të dukshme.

Lejohen kalimet e tubacioneve përmes ambienteve të ndërtesës me kusht që ato të kalojnë brenda tubave të tjerë metalikë të hapur, me diametër të paktën 2 cm më të madh se tubacioni i brendshëm dhe në të dyja anët të komunikojnë me jashtë.

24. IMPIANTET ANTIZJARR

Për ndërtesat të tipit “b”, “c”, “d”, “e” sipas tabelës A, duhet të vendoset rrjet hidrantësh të brendshëm, si më poshtë:


- Impianti hidrik duhet të ketë prurje normale furnizimi nga ujësjellësi publik.
- Kur ky ujësjellës nuk garanton kushtet e mësipërme, për objektin duhet të realizohet një rezervë hidrike me të njëjtin kapacitet.
- Rrjeti i hidrantëve duhet të përbëhet të paktën nga një kolonë uji, për çdo kafaz shkallësh, nga i cili duhet të dalë në çdo kat të paktën një hidrant antizjarr, në mur ose jashtë tij.
- Tubi antizjarr, që ka hidranti, duhet të jetë me diametër të paktën Ø 25 mm – 52 mm dhe me gjatësi të atillë, që të arrijë të gjithë zonën e katit.
- Një tub i tillë duhet instaluar dhe në zonën e filtrit, në qoftë se shkalla është e tipit të provës së brendshme të tymit.
- Në këmbët e çdo kolone duhet të jetë instaluar një degëzim me lidhje për autopompën zjarrfikëse.
- Impianti duhet të ketë dimensione të atilla që të garantojë një prurje minimale prej 360 l/min për çdo kolonë të montuar dhe në rastin e shumë kolonave të garantojë funksionimin e njëkohshëm të tyre.
- Furnizimi me ujë duhet të jetë në gjendje të sigurojë furnizimin me ujë të 3 hidrantëve me prurje 120 l/min, me një presion statik në gjendje të mbyllur prej 1.5 bar, për një kohë të paktën 60 min.
- Në qoftë se rrjeti ujësjellës nuk garanton parametrat e mësipërm atëherë duhet siguruar një rezervë ujore, e cila duhet të vendoset në bodrume (kate të nëndheshme) ose në katet e para, që të furnizohet nga rrjeti ujësjellës publik ose nga burime të tjera.
- Kjo rezervë duhet të mbahet gjithmonë e plotë.
- Elektropompat e sistemit të hidrantëve antizjarr duhet të jenë të lidhura në rrjetin elektrik të ndërtesës nëpërmjet linjave elektrike, që nuk furnizojnë të tjera pajisje (linja të dedikuara).

- Në ndërtesa të tipit “d”, “e”, grupi i pompave të sistemit antizjarr duhet të përbëhet nga dy pompa, (motopompë + elektropompë) njëra rezervë dhe tjetra e ushqyer nga një rrjet elektrik i pavarur, (shih skemën e sistemit të pompimit automatik zjarrfikës bashkëlidhur).

- Ndezja e sistemit të pompave duhet të jetë automatike.
- Tubacionet e furnizimit të rrjetit dhe ato të vetë rrjetit hidrik duhet të jenë të mbrojtura nga ngrica, goditjet dhe zjarri. Kolonat e ujit mund të jenë të futura në mur, ose në kafazin e shkallëve, ose në ambiente me rezistencë nga zjarri të paktën REI 60.

POMPË KRYESORE ELEKTRIKE

Furnizon të tërë impiantin me ujë sipas presioneve të dëshiruara. Rindezje automatike, kur rënia e presionit është e madhe; fikje automatike kur presioni ka arritur nivelin e dëshiruar (është e pajisur me kontroll takim /stakimi presioni). Pjesë përbërëse: një pompë centrifugale me një ose më shumë shtytës të vendosur horizontalisht ose vertikalisht të montuara në një motor elektrik asinkron 400/690 V; 50 Hz; 2900 rpm ose 1500 rpm.



POMPË KRYESORE DIEZEL

Siguron furnizimin me ujë me presionin e dëshiruar të të gjithë impiantit. Ndezje automatike në rastet, kur pompa kryesore elektrike nuk arrin të ndizet ose presioni bie; ndalim automatik, kur presioni ka arritur nivelin e dëshiruar (është e pajisur me kontroll takim/stakimi presioni). Pjesë përbërëse; një pompë centrifugale me një ose më shumë shtytës të vendosur horizontalisht ose vertikalisht të montuar në një motor diesel me ftohës me ajrosje me ujë, me një apo disa cilindra dhe i kompletuar me ndezës elektrik. Bateri dhe rezervuar naftë.

POMPË STARTER

Siguron furnizimin e tankut e bymimit dhe mbulon humbjet e vogla të presionit. Kjo pompë ndizet e para kur presioni zbret, (është e pajisur me kontroll automatik takim/stakimi nga presioni). Pjesë përbërëse; një pompë centrifugale me një ose më shumë shtytës të vendosur horizontalisht ose vertikalisht të montuara në një motor elektrik asinkron 400 / 690 V; 50 Hz; 2900 rpm ose 1500 rpm.



REZERVUAR BYMIMI

Siguron ruajtjen e një presioni konstant dhe mbrojtjen nga shoku hidraulik. Pjesë përbërëse: një rezervuar cilindrik i lyer nga brenda me një shtresë rezine epoksidike kundër korrozionit; veshje e brendshme e zëvendësueshme.

PANELI I KONTROLLIT AUTOMATIK

Siguron një gatishmëri permanente për një aktivitet automatik të grupit.

Ndezje / shuarje automatike / manual; sistem ndezje automatike diesel me përpjekje të përsëritura të ndezjes në rastin kur nuk arrin të ndizet. Sistem ngarkimi baterish, orëmetër: sistem automatik i programimi të operacioneve të punës.

PAJISJE HIDRAULIKE

Komplet i plotë tubash çeliku me veçori të larta rezistencë ndaj presionit.

PAJISJE KONTROLI DHE MBROJ-TJEJE: Çelësa presioni që kontrollojnë secilin komplet pompimin; manometër glicerinë që tregon nivelin e presionit të ujit, valvule bronzi moskthimi ose valvule hidrostop për çdo komplet pompe. Çelës ndalimi uji për çdo komplet pompë.

STRUKTURA BAZË

Laminë çeliku unike ST 37 - 2: me 4 ose 6 amortizatorë vibrimi.

24.1 HIDRANT DN 20

Objektet e tipit “a”, me lartësi deri në 12-24 m duhet të jenë të paktën pajisur me hidrantë DN 20.

Çdo hidrant duhet të jetë pajisur me një tubacion të gjatë 20 m. Dy hidrantë në pozicione hidraulike të kundërta, duhet të sigurojnë në çdo dalje prurje jo më të vogël se 35 l/min, me një presion jo më të vogël se 1.5 bar, kur kemi hyrë në fazën e shkarkimit.

Çdonjëri prej tyre duhet të sigurojë një pavarësi jo më të vogël se 60 minuta. Kur rrjeti hidrik nuk siguron përshkrimet e mësipërme, duhet përdorur ushqim rezervë, me kapacitet të njëjtë aftësie dhe të

furnizojë me të njëjtin presion.

24.2 HIDRANT DN 45

Objektet e tipit “b”, me lartësi 24-32 m duhet të jenë të pajisur me hidrantë DN 45. Çdo hidrant duhet të jetë pajisur me një tub fleksibël të gjatë 20 m.

24.3 HIDRANT DN 70

Objektet e tipit “c”, “d”, “e”, me lartësi antizjarr mbi 32-80 m, duhet të jenë të pajisur me një hidrant DN 70, i arritshëm në kohën e duhur të sinjalizimit, i dobishëm për ndërhyrjen e strukturave të zjarrfikësve.

Këto hidrantë duhet të sigurojnë të paktën një prurje jo më të vogël se 460 l/min për të paktën 60 minuta.

Në rastet e të njëjtit rrjet ushqimi, ku hidrantët e brendshëm janë të njëjtë me ato të jashtëm, prurja e ushqimit sigurohet me përdorim kompleks në përshtatje me nevojën.

25. FIKSIT E ZJARRIT

Në ndarjet e kateve në dhe nën kuotat ± 0.00 që shërbejnë për veprimtari tregtare, ose veprimtari të ndryshme, në ndihmë të komunitetit vendosen fikës zjarri sipas specifikimeve të mëposhtme:

- Fikësit e zjarrit duhet të jenë të harmonizuara dhe të certifikuara konform kritereve të përcaktuara në një nga vendet e Komunitetit Europian.

- Fikësit e zjarrit duhet të jenë shpërndarë në hapësirë në mënyrë uniforme, ku të paktën njëri prej tyre duhet të gjendet:

- PËRBRI pajisjeve që mund të shërbejnë si ndezës zjarri;
- afër zonave me potencial rreziku zjarri.

Fikësit e zjarrit duhet të vendosen në pozicione lehtësisht të arritshme dhe të shikueshëm nga njerëzit.

Mbishkrimi i udhëzuesit tregues në fikësin e zjarrit duhet të jetë lehtësisht i lexueshëm në distancë. Fikësit portativë duhet të jenë të instaluar çdo 200 m² katror të dyshemesë, ose minimumi një fikës për çdo kat.

- Fikësit e zjarrit portativë duhet të kenë kapacitet shuarje jo më të vogël se 13 A- 89 B.

Për mbrojtjen e hapësirave dhe impianteve me rrezik specifik duhet të jenë parashikuar fikës zjarri që t'i përshtaten situatës specifike.

26. NORMA TRANZITORE

Në ndërtesat ekzistuese, brenda 10 (dhjetë) vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të këtyre rregullave, duhet të aplikohen, hap pas hapi, rregullat e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, sipas këtyre normave.

27. KOMUNIKIMI

Në ndërtesat të tipit “b”, “c”, “d”, “e”, lejohet komunikimi, sipas pikës 14 nëpërmjet portave RE 30, edhe pa filtrin e provës së tymit ose daljen direkte jashtë ndërtesës.

28. NDRIÇIMI I EMERGJENCËS

Në ndërtesat të tipit “c”, “d”, “e”, duhet të instalohet një sistem ndriçimi emergjence sipas përcaktimeve në pikën 22.

29. IMPIANTET ANTIZJARR

Në ndërtesat të tipit “c”, “d”, “e”, duhen instaluar impiante antizjarr sipas përcaktimeve në pikën 24.

Janë të vlefshëm dhe impiantet e instaluar ekzistuese me kusht që të plotësojnë kushtet hidraulike sipas pikave 24, 24.1, 24.2, 24.3.

30. RRUFEPRITËSIT

Për të evituar rrezikun e zjarrit, që mund të vijë nga shkarkimet atmosferike, objektet e klasifikuara në dispozitën 1.1 të rregullave të këtij vendimi duhet të pajisen me sistemin mbrojtës për shkarkimet atmosferike.

Ky sistem duhet të ndërtohet dhe është pjesë e projektit teknik që shoqëron dokumentacionin e

objektit dhe është objekt kontrolli nga strukturat e PMNZSH-së.